



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Kuvendi i Kryeqytetit
Skupstina Glavnog Grada - Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Shërbime Publike, mbajtur më 9.11.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: Besnik Mujeci, Granit Geci, Dasmor Durmishi, Diellza Namani.
Mungoi: Berat Lahu.

Në mbledhje mori pjesë edhe: Ilirik Musliu, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Besnik Mujeci, me këtë:

R E N D T Ë D I T Ë S

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Shërbime Publike;
2. Raporti i drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike për punën gjatë muajit shtator;
3. Te ndryshme.

Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, për zv. kryesues të Komitetit për Shërbime Publike u emërua Granit Geci.

Pika e parë

Miratimi dhe shqyrtimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes inauguruese të Komitetit për Shërbime Publike.

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Komitetit për Shërbime Publike.

Pika e dytë

Raporti i drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike për punën gjatë muajit shtator.

Ilirik Musliu, drejtor tha se dua me e bërë një përmbledhje të punëve që kemi kryer, pra duke u nisur nga ndriçimi apo mirëmbajtja e ndriçimit publik, si dhe kemi përgatitur edhe disa të dhëna teknike për me e shikuar numrin e rrugëve sa është intervenuar në ato rrugë.

Përveç mirëmbajtjes së ndriçimit publik, kemi ecur shumë mirë me sinjalistikë dhe shenjëzim, ndërsa sa i përket transportit publik, tha se e kemi përmyllë master planin me BERZH-in, ku mendojmë që në janar të 2024 të realizohet kjo, ku 161 autobusë janë të paraparë për me funksionuar me plan të mobilitetit në transportin publik në Prishtinë dhe mendojmë që ti sjellim edhe 31 të tjerë dhe 6-8 prej tyre mendojmë me qenë autobus elektrik.

Mirëpo ne e kemi ndryshuar kërkesën si DSHP, për arsye se kur e kemi bërë organizimin dhe dizajnimin e linjave, ka dalë si kërkesë që duhet me pasur edhe minibus, për shkak që zonat rurale dhe disa zona brenda qytetit nuk kanë linja, p.sh. në lagjen "Arbëria", nuk ka linjë.

Ndërsa sa i përket menaxhimit të mbeturinave e kemi bërë inaugurimin e qendrës së kompostimit, ku fillimisht kjo qendër mendohet me funksionuar vetëm me "Hortikulturën", d.m.th që ato mbetje kthehen në pleh, dhe atë pleh "Hortikultura", ka me e shfrytëzuar për nevoja të veta për mbjellje.

Përveç "Hortikulturës", mendohet që edhe "Pastrimi", me i dërguar mbetjet atje me qëllim që me u rritë kjo sasi dhe mandej Drejtoria e Bujqësisë, me e shfrytëzua plehun për bujq, me ju dhënë si subvencion bujqve.

Ai mes tjerash tha se jemi në diskutim me CMSR-në, sllovene që ka qenë pjesë e projektit të qendrës së kompostimit dhe po mendojmë që ata me bërë një investim me disa pajisje ekstra për të mundur që prej këtij kompostimi me bërë pelet dhe peletin me e shfrytëzua Drejtoria e Arsimit për shkolla, për ngrohje sepse është kërkesë shumë e madhe.

Po ashtu ne e kemi gati me e nënshkruar kontratën për blerjen e kontejnerëve, janë më shumë se 1000 kontejnerë që i ka blerë Komuna e Prishtinës, në koordinim dhe bashkëpunim me ndërmarrjen "Pastrimi", por që gjithmonë në mbikëqyrjen tonë, ku dhe do ta bëjmë shpërndarjen nëpër lokacione, kemi me i ndërruar kontejnerët e dëmtuar dhe kemi me e shtuar numrin tek disa lokacione sepse nuk është numri i duhur. Gjithashtu për vitin 2023, është e paraparë me u bërë qendra e grumbullimit të trajtimit të mbeturinave ndërtimore.

Dasmor Durmishi, lidhur me diskutimin rreth pastrimit shtroi pyetje se pse "Pastrimi", nuk mundet me mbërri me kohë i krye këto shërbime.

Ilirik Musliu, drejtor tha se "Pastrimi", nuk mundet me mbërri për shkak që nuk ka kapacitet.

Dasmor Durmishi, tha se sa i përket kapacitetit, ndërmarrjes "Pastrimi", duhet të krijohen të gjitha mundësitë që ajo t'i kryej shërbimet me kohë, si p.sh. duhet shikuar mundësinë në ngritjen e çmimit të faturave.

Ilirik Musliu, drejtor tha se ne si DSHP, jemi duke punuar edhe me Zyrën Ligjore, që ajo me qenë kompani e dedikuar vetëm për Prishtinën që edhe përkundër asaj se ne jemi me 77% e më shumë aksionar dhe nuk e gëzojmë asnjë të drejtë më shumë se të tjerët që i kanë 2% apo 3%. Si drejtori ne duhet ta bëjmë një thirrje, me e gjete një kod buxhetor, me angazhuar një kompani profesionale për me e bërë vlerësimin e aseteve dhe mandej me i ndarë asetet dhe me e sjellë në

Kuvend, kështu që si ndërmarrje pa pasur obligime edhe për rajonet e tjera ne do ta kemi shumë më lehtë me bërë investime dhe për të blerë makineri.

Një prej problemeve që e kemi me "Pastrimin", momentalisht "Pastrimi", e ka një prej lloteve, ne i kemi 11 llote të mirëmbajtjes dimërore, 7 llote janë urbane, 4 janë rurale, kështu që për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve nuk ka kapacitete të duhura. Për këtë jemi duke dashtë me bërë aneks kontratë për disa rrugë të cilat nuk janë në mirëmbajtje.

Nuk i di konkret se cilat rrugë janë, p.sh. ka raste ku dy rrugë janë paralelisht, njëren e kanë përfshirë e tjetrën jo. Ne e kemi vendosur ekipin në terren për me i marrë shënimet, me i marrë të dhënat, me e pa se cilat janë rrugët, sa janë kilometrat me qëllim që të mundemi me i shtuar me aneks kontratë të gjitha rrugët edhe rurale dhe ato të qytetit me qenë të përfshira në mirëmbajtjen dimërore.

Besnik Mujeci, shtroi pyetje lidhur me ndriçimin publik ku thotë se si do ia bëni me kërkesën e Qeverisë me e kursyer rrymën.

Ilirik Musliu, drejtor lidhur me pyetjen e shtuar nga z. Durmishi tha se karshi komunave të tjera e mira e Prishtinës si Kryeqytet është pozicioni, pasi që tek ne diku 97% e ndriçimit është lled, d.m.th që e bënë diferencën menjëherë.

Nuk ka kërkesë për me e ndalë, ka kërkesë me investuar, me u zëvendësuar me ndriçim lled e që në këtë rast nuk ka të bëjë me neve, sepse Prishtina 97% të ndriçimit e ka lled, ku edhe fatura mujore të tregon që ne maksimum paguajmë diku 38 mijë euro.

Dasmor Durmishi, pyeti se a janë evidentuar pikat e stacioneve të autobusëve në "Kodrën e Trimave", dhe a e dini se ku kanë qenë ato të vjetrat si dhe a është e mundur me i vendos prapë aty ku kanë qenë, ku njëra ka qenë tek shkolla fillore "Asim Vokshi", dhe tjetra tek trafoja, pasi që është kërkesë nga të moshuarit që me bërë linjën bile dy herë në ditë në mëngjes dhe mbrëmje, Kodra e Trimave - Gërmi.

Ilirik Musliu, drejtor tha se po aty do të vendosen, mirëpo arsyeja pse nuk janë vendosur, është për shkak të një kontrate që e kemi trashëguar ka pasur shumë mangësi, kurse disa kontrata kemi arritur t'i evidentojmë. Kemi dalë dhe i kemi përcaktuar 50 stacionet e para të formatit "A" ku do të vendosen si p.sh ajo të katedralja 9 m2 dhe 6m2, kështu që këto stacione do të jenë me ngjyrë të verdhë.

Sa i përket kërkesës për linjën "Kodra e Trimave - Gërmi", bashkë me ekspertët e BERZH-it, jemi duke punuar në ridizajnimin dhe riorganizimin e sajë, mendoj që deri në fund të vitit "Kodra e Trimave", mundet me i pasur stacionet.

Duke pasur parasysh të gjitha diskutimet, sugjerimet dhe pyetjet e shtruara nga anëtarët e komitetit tha se, meqë kemi trashëguar një bashkëpunim jo të mirë, mendoj se jemi duke punuar në atë drejtim që të bëjmë zgjidhje të përhershme dhe të bëjmë më të mirën.

- Pika e tretë
 - Të ndryshme
- Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja mbaroi në orën 17:40

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesi i Komitetit

Berat Lahu



Faqe 4 nga 4